



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT**



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: [+355 4 2380 300/315](tel:+35542380300315)  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

**REKOMANDIM**

**Mbi veprimtarinë e institucioneve të: Policisë së Shtetit, Prokurorisë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, në lidhje me trajtimin e rastit të tubimit të datës 31.03.2018 në "Rrugën e Kombit", për kundërshtimin e tarifës së vendosur për kalimin në këtë rrugë**

## **PËRMBAJTJA:**

	Faqe
I. Hyrje	
II. Procesi i rregullt ligjor	6
III. Zhvillimi i ngjarjes. Veprimet e Policisë	8
IV. Veprimet e organit të Prokurorisë	20
V. Procesi gjyqësor	26
VI. Konkluzione	33

## 1. Hyrje

Respektimi i të drejtave të njeriut është sot një ndër prioritetet e rëndësishëm të strategjive politike të shteteve që aspirojnë integrimin në strukturat rajonale e globale. Si i tillë, ai përbën një çështje themelore për institucionet dhe organet publike në vendin tonë, për programet e zhvillimit të qëndrueshëm e afatgjatë, për politikën qeverisëse në përgjithësi dhe për mirëqeverisjen në veçanti.

Duke u përafuar me standardet më të mira ndërkombëtare është e kuptueshme se, mirëqeverisja dhe mirëadministrimi, si një premisë e tagrit të çdo personi për një trajtim të çështjeve të tij nga institucionet dhe organet publike, në mënyrë të paanshme, të ndershme dhe brenda një kohe të arsyeshme, përbën çelësin e suksesit në raportin e drejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet proceseve vendimmarrëse dhe zbatimit të vendimeve të miratuara, si dhe mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut. Mirëqeverisja pra, duhet të përfaqësojë një interes të përhershëm dhe dinamik, që nxit respektimin e shtetit të së drejtës, transparencën, besimin publik dhe pjesëmarrjen e gjerë në proceset demokratike vendimmarrëse.

Të drejtat e njeriut nuk janë vetëm rrjedhojë e mirëqeverisjes. Ato janë dhe duhet të jenë edhe shkak, nxitje për progresin e saj. Mirëqeverisja është e mundur vetëm në një shtet e në një shoqëri të lirë, atje ku respektohet e vlerësohet njeriu, institucioni, shteti, ligji e drejta. Atje ku dhunohet fjala e lirë, ku mungon liria e veprimit, ku dominon korrupsioni e kompromentimi, rrënohen, gërryhen themelet e mirëqeverisjes.

*Qeverisësit kanë mbi vete një përgjegjësi të madhe për t'u siguruar të qeverisurve vëllimin maksimal të të drejtave dhe lirive themelore të sanksionuara nga normat e së drejtës së brendshme apo asaj ndërkombëtare, si dhe standartet optimale në fushën e shëndetit, kulturës, arsimit, banimit, jetesës në përgjithësi, sigurimit të një gjyqësori të pavarur, të paanshëm e objektiv, si dhe të gjithë aspektet e tjerë të shërbimit publik në përgjithësi.*

Ky spektër i gjerë të drejtash dhe lirish themelore të shpallura në një varg

dokumentesh juridiko-ndërkombëtare dhe të sanksionuara në të drejtën e brendshme të shumë shteteve gjen pasqyrim edhe në legjislacionin shqiptar. Ai plotësohet nga deklarimi konstitucional që askush nuk duhet t'i nënshtrohet arbitrarisht arrestimit, ndalimit ose internimit dhe që gjithkush gëzon njëlloj të drejtën për një proces të rregullt ligjor, në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të veta dhe për vendimin mbi çfarëdo lloj akuze penale kundër tij.

Në këtë këndvështrim, Avokati i Popullit, ka ndjekur me vëmendje, në një pozicion dinamik proaktiv, në ushtrim të mandatit të tij kushtetues të gjitha rastet problematike që lidhen me ushtrimin dhe respektimin e të drejtave dhe interesave të ligjshme të komuniteteve të gjera dhe jo vetëm. E tillë ka qenë edhe situata e krijuar në protestën e zhvilluar në datën 31.03.2018, në “Rrugën e Kombit” nga një grup qytetarësh, të cilët kundërshtonin vendosjen e tarifës për kalimin në këtë rrugë.

Në këto rrethana Avokati i Popullit ka filluar ndjekjen e kësaj çështjeje me iniciativë, në përputhje me paragrafin e tretë, të nenit 13, të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar. Paralelisht, çështja e vendosjes së kësaj tarife mirëmbajtjeje për “Rrugën e Kombit” është bërë tashmë objekt i një hetimi tjetër administrativ nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit.

**Që në momentet e para, Avokati i Popullit ka bërë publik qëndrimin se, është një e drejtë e padiskutueshme e çdo qytetari, e drejta për t’u organizuar dhe kundërshtuar vendime të padrejta, apo të debatueshme të autoritetit qeverisës. Megjithatë, dhuna si mjet kundërshtimi ndaj një padrejtësie duhet shmangur në të gjitha rrethanat.**

Në këto rrethana nevojitet përgjegjshmëria dhe vetëpërmbytja e dyanshme, kuptuar këtu edhe nga ana e organeve të ruajtjes së rendit, duke konsideruar se përgjigjja me dhunë ndaj dhunës, prodhon vetëm spirale të pafundme dhune.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka vlerësuar se, sikundër është e këshillueshme që qytetarët të shmangin dhunën në shprehjen e pakënaqësisë

së tyre ndaj çdo lloj padrejtësie, po ashtu është krejtësisht e mundshme që autoritetet ligjvënëse të shmangin vendimet që i shtyjnë qytetarët drejt dëshpërimit dhe akteve të tij. Prania në ligjërimin publik politik, e etiketimeve fyese dhe denigruese ndaj qytetarëve protestues, si dhe gjuha e urrejtjes e manifestuar publikisht, i shërben vetëm nxitjes së acarimeve të mëtejshme dhe nuk kontribuon aspak për zgjidhjen e situatës, që mund të zgjidhet vetëm me dialog dhe respekt të ndërsjelltë për gjetjen e të gjitha rrugëdaljeve ligjore.

Institucioni i Avokatit të Popullit, sikurse ka vepruar dhe vepron në të gjitha rastet e ngjashme ka qenë në vazhdimësi i pranishëm me grupet përkatëse të inspektimit, në cilësinë e ekipeve faktmbledhëse, për të vëzhguar dhe vlerësuar situatën e krijuar në rrethin e Kukësit, pas protestës së qytetarëve, e cila përfundoi faktikisht në një përplasje të dhunshme.

Përfaqësuesit e institucionit të Avokatit të Popullit kanë kryer për këtë qëllim takime e vizita në Drejtorinë e Policisë, Prokurorinë e Rrethit gjyqësor Kukës, në spitalin e qytetit, si dhe me përfaqësues të grupimeve shoqërorë që kanë iniciuar protestën e zhvilluar në Kukës, apo edhe me qytetarë, të cilët kanë marrë pjesë apo kanë mbështetur këtë protestë.

Nuk kanë munguar në vazhdim edhe takime e vizita në Drejtorinë e Policisë së Shtetit, si dhe në Komisariatet përkatëse të Policisë së Tiranës, ku janë mbajtur të arrestuarit. Monitorimi ka qenë i vazhdueshëm edhe për veprimtarinë e organit të Prokurorisë si dhe për vendimmarrjen e Gjykatës, mbi masat e sigurisë ndaj personave të ndaluar menjëherë pas protestës.

Numri i madh i ankesave, shqetësimeve dhe referimeve të qytetarëve ndaj veprimtarisë së autoriteteve në trajtimin e situatës gjatë dhe pas kësaj proteste, kanë sjellë në vëmendje nevojën për ndërgjegjësimin e strukturave shtetërore për të kuptuar se **standardi për zbatimin e ligjit duhet të jetë më i lartë për përfaqësuesit e organeve shtetërore, sesa për qytetarët.**

Avokati i Popullit gjen rastin të sjellë në vëmendjen e organeve shtetërore e ligjzbatues, por edhe të publikut të gjerë se, sipas nenit 2 të Ligjit 8454, datë

4.2.1999, “Per Avokatin e Popullit” i ndryshuar, ai (Avokati i Popullit) është nxitës i standarteve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend.

Mbi bazën e konstatimeve dhe gjetjeve përkatëse, Avokati i Popullit ka përgatitur këtë informacion konstatues dhe rekomandues pararendës (eventualisht) për një raport të veçantë i cili si bosht kryesor të tij, ka monitorimin e situatës së respektimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor për të gjithë qytetarët e shoqëruar apo arrestuar pas protestës, në të gjitha hallkat procedurale ligjore të ndjekura nga ana e Policisë së Shtetit, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës, si dhe Gjykatës së Shkallës së Parë, Kukës.

Ky monitorim ka qënë dhe do të vijojë të kryhet me korrektesë dhe përgjegjësi maksimale institucionale, për të bërë të mundur garantimin e të drejtave të ligjshme të qytetarëve.

Avokati i Popullit vëren se ka një ndërgjegjësim më të madh të qytetarëve në lidhje me njohjen dhe kërkesën që të drejtat e tyre të respektohen. Ka një rritje të kërkesës së përgjithshme për të pasur transparencë nga organet ligjzbatues dhe një gjë e tillë duhet përshëndetur. Ushtrimi i një presioni pozitiv e rrit në përgjithësi përgjegjshmërinë me të cilën ushtrohen apo duhet të ushtrohen detyrat shtetërore nga personat që cakton ligji për zbatimin e tyre.

## **II. Procesi i rregullt ligjor**

Procesi i rregullt ligjor është një karakteristikë e pandashme e shtetit të së drejtës, si një e drejtë kushtetuese dhe një e drejtë e afirmuar në akte ndërkombëtarë. E drejta për një proces të rregullt ligjor paraqitet si një garanci për shtetasit ndaj veprimeve të padrejta dhe të paligjshme të organeve të pushtetit shtetëror nga njëra anë dhe nga ana tjetër si detyrim i këtyre të fundit për të mos cënuar të drejtat dhe liritë e shtetasve, pa siguruar respektimin e procedurave ligjore.

Duke qënë një e drejtë themelore e individit e afirmuar në nenin 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, duhet theksuar se Konventa

Europiane e të Drejtave të Njeriut, në nenin 6 të saj, paraqet një formulim më të gjerë lidhur me këtë të drejtë se ai i dhënë në Kushtetutën tonë, ku krahas të drejtës për gjykim të drejtë, publik dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanëshme e caktuar me ligj, përfshihen edhe disa standarte të tjera.

Kështu, e drejta për t'u dëgjuar para gjykimit, e drejta e prezumimit të pafajësisë derisa të provohet fajësia nga gjykata, e drejta e të akuzuarit për t'u informuar brenda një afati sa më të shkurtër dhe në gjuhën e tij për akuzën si dhe e drejta për t'u mbrojtur, përbëjnë sipas nenit 6, të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, thelbin e të drejtave procedurale të procesit të rregullt ligjor, ndërkohë që ato nuk gjenden në përmbajtjen e nenit 42, të Kushtetutës.

Procesi i rregullt ligjor ndër elementët thelbësore të tij ka prezumimin e pafajësisë. Prezumimi i pafajësisë si një parim dhe e drejtë e parashikuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (neni 30, 31), gjithashtu dhe nga Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut (neni 6), nënkupton që i dyshuari konsiderohet i pafajshëm, deri në provimin e fajësisë nga gjykata kompetente, bazuar në prova dhe fakte të evidentuara.

Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut, në mënyrë të përsëritur ka pranuar se garancia ligjore e parashikuar nga neni 6 i Konventës, **qëllim kryesor të saj**in ka të realizojë në mënyrë bindëse, nëpërmjet prokurorit akuzat gjatë një procedimi penal, çka nënkupton se hapat ndërmjet prezumimit të pafajësisë si masë mbrojtëse dhe vërtetimit të fajësisë duhet të respektojnë në mënyrë rigorozë dhe me standartet më të larta, hapësirën ligjore përkatëse.

Po çfarë mbron prezumimi i pafajësisë? Ky parim, koncept i së drejtës, i sanksionuar ligjërisht, pak herë gjen zbatim praktik gjatë procedurës penale. Nëse gjatë një procedimi të tillë nuk respektohen të drejtat dhe liritë e individit, që në momentin e ndalimit të tij (orët e vona të natës), momentin e informimit të familjareve të tij, etj., mënyrën e trajtimit dhe realizimin e të drejtave procedurale të parashikuara nga ligji, atëhere këtu nuk ndodhemi përpara garantimit të kësaj të drejte, por ndodhemi përpara faktit të kundërt:

prezumimit të fajësisë, prezumimit dhe dhënies së vendimit përpara gjykimit, në kundërshtim me përcaktimet për një proces të rregullt ligjor!

A nuk shtrohet me shumë të drejtë pyetja: Individit prezumohet i pafajshëm apo fajtor? Nëse nuk respektohet ky parim, atëherë nuk është respektuar e drejta për një proces të rregullt ligjor dhe rrjedhimisht nuk rezulton se janë respektuar të drejtat dhe liritë e sanksionuara me ligj të individit!

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon se Shqipëria është shtet i së drejtës çka do të thotë se **e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit.**

Nëse shteti nëpërmjet organeve të tij dështon të respektojë parimet dhe procedurat ligjore, atëherë, si mundet të garantojë ai prezumimin e pafajshëm të një individit? Si mund të procedohet një individ nëpërmjet parimit të një procesi të rregullt ligjor, kur të drejtat e tij janë cënuar haptazi?

Për këto arsye, si mbrojtës dhe garant të respektimit të ligjit, të drejtave dhe lirive të njeriut, institucioni i Avokatit të Popullit, konstaton se ndodhemi përpara faktit kur procedurat e parregullta, të konstatuara në respektim të realizimit dhe respektimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, çojnë drejtëpërdrejtë në cënimin e të drejtave të individit.

Më konkretisht, duke ndjekur rrjedhën e zhvillimit të ngjarjeve dhe konstatimeve të kryera nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit, në vazhdim të këtij informacioni konstatues dhe rekomandues, janë renditur shkeljet dhe parregullsitë e gjetura për një proces që fillon që nga veprimet e Policisë së Shtetit, vazhdon me veprimet e organit të Prokurorisë dhe kulmon me seancën gjyqësore për dhënien e masës së sigurimit ndaj personave të ndaluar nga ana e punonjësve të Policisë së Shtetit.

### **III. Zhvillimi i ngjarjes. Veprimet e Policisë**

Nga verifikimet e kryera dhe informacionet e marra në qytetin e Kukësit, në datën 13.04.2018, si në organin e Prokurorisë, pranë Gjykatës së Shkallës së



Parë Kukës, në Gjykatën e Shkallës së Parë, Kukës, dhe në Drejtorinë Vendore të Policisë (DVP), Kukës, ka rezultuar se:

Këshilli Bashkiak Kukës, me shkresën nr. 1571 prot, datë 28.03.2018, ka njoftuar Komisarariat të Policisë Kukës, për organizimin e një tubimi në datën 31.03.2018. Qëllimi i këtij tubimi ka qenë anulimi i taksës së “Rrugës së Kombit” për banorët e Bashkisë Kukës. Nga pikëpamja formale kjo kërkesë rezulton të jetë bërë brenda afatit të parashikuar në nenin 5, të Ligjit nr.8773, datë 23.4.2001, “Për Tubimet”.<sup>1</sup> Ajo gjithashtu rezulton të përmbajë pjesën më të madhe të kërkesave formale të parashikuara nga ligji dhe eventualisht në të mungon numri i personave mbeshtetës që do të merrnin pjesë në protestë dhe percaktimi i emrave nominale e jo me përshkrim të përgjithshëm siç ishte treguar në njoftimin për protestë.

Komisariati i Policisë Kukës, më shkresën nr. 729/1 prot, datë 30.03.2018, ora 10:00 u ka kthyer përgjigje organizatorëve, Këshillit Bashkiak Kukës. Nëpërmjet kësaj përgjigjeje është konstatuar se, njoftimi i kryer për organizimin e tubimit nuk plotëson kriteret ligjore të parashikuara në ligjin “Për tubimet”, si dhe vendi i kërkuar për tubim nuk është i përshtatshëm, pasi bëhet pengesë për lëvizjen normale të shtetasve dhe të automjeteve. Ndërkohë për këtë problem, në datën 30.03.2018 nga ana e Shefit të Komisarariatit të Policisë, Kukës, janë zhvilluar dy takime me Kryetarin e Këshillit Bashkiak. Në vijim dhe pas përgjigjes së policisë, Këshilli Bashkiak Kukës i ka dërguar një njoftim tjetër Komisarariatit të Policisë Kukës, duke plotësuar disa të dhëna të nevojshme për këtë qëllim, sipas ligjit “Për tubimet”.

**Nuk rezulton që Shefi i Komisarariatit të Policisë, Kukës, të ketë nxjerrë ndonjë vendim administrativ, për ndalimin e zhvillimit të tubimit, apo për**

---

<sup>1</sup> Në nenin 5, të Ligjit nr.8773 datë 23.04.2001 “Për tubimet”, thuhet shprehimisht se:

“1. Në rast tubimi në sheshe ose vendkalime publike, organizatori dhe drejtuesi janë të detyruar të njoftojnë me shkrim shefin e komisarariatit të policisë jo më vonë se tri ditë para datës së zhvillimit të tubimit. 2. Njoftimi me shkrim duhet të përmbajë: a) identitetin dhe adresën e drejtuesit dhe të organizatorit të tubimit; b) qëllimin e tubimit; c) datën, vendin, orën e fillimit dhe të përfundimit të tubimit dhe itinerarin e tij (nëse ka të tillë); ç) numrin e përafërt të pjesëmarrësve dhe numrin e personave ndihmës në mbarëvajtjen e tubimit; d) personat që do të flasin në tubim. 3. Në rast se njoftimi me shkrim nuk i përmban elementet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni, ai i kthehet për plotësim organizatorit dhe drejtuesit të tubimit, të cilët duhet ta riparaqesin atë të plotësuar jo më vonë se 24 orë para kohës kur do të zhvillohet tubimi.

**përcaktimin e kohës dhe vendit të zhvillimit të tubimit,**<sup>2</sup> në lidhje me kërkesën e dytë të konsideruar të plotësuar prej organizatorëve sipas nenit 6, të ligjit “Për Tubimet”.

Përveç kërkesës së Këshillit Bashkiak, Kukës, Komisarariatit të Policisë Kukës i ka shkuar edhe një njoftim për organizim tubimi, nga një shtetas i quajtur Arben Kola. Komisarati i Policisë, Kukës me shkresën nr. 729/1 prot, datë 30.03.2018 i ka kthyer përgjigje atij duke e njoftuar se, leja nuk mund të jepej, pasi kërkesa e tij nuk plotëson kërkesat e ligjit dhe se, vendi i organizimit të saj ishte i papërshtatshëm.

Sjellim në vëmendje faktin se, në nenin 6, të Ligjit nr.8773, datë 23.4.2001, “Për Tubimet”, përcaktohet se:

“1. Shefi i Komisarariatit të Policisë, brenda 24 orëve nga marrja e kërkesës sipas pikës 2 të nenit 5, ose brenda 8 orëve nga marrja e kërkesës sipas pikës 3, të nenit 5, të këtij ligji me vendim të arsyetuar duhet:

- a) t’i komunikojë organizatorit ose drejtuesit të tubimit ndalimet dhe kufizimet e mundshme ose kushtet e tjera, duke përfshirë edhe numrin e personave që do të ndihmojnë në mbarëvajtjen e tij,
  - b) t’u japë kopje të urdhrin zyrtar për caktimin e oficerit të policisë që do të jetë përgjegjës për të ndihmuar dhe vëzhguar zhvillimin e tubimit,
2. Shefi i Komisarariatit të Policisë njofton me shkrim drejtuesin e pushtetit vendor dhe prefektin për zhvillimin e tubimit”.

Në rastin e kërkesës për tubim të paraqitur me shkresën nr. 1571 prot, datë 28.03.2018, nga ana e Këshilli Bashkiak Kukës, nga ana e autoritetit përkatës të cilësuar nga ana e ligjit, pra nga ana e Shefit të Komisarariatit Kukës, rezulton se janë kryer disa shkelje:

---

<sup>2</sup> Në nenin 8, të Ligjit nr.8773 datë 23.04.2001 “Për tubimet”, thuhet shprehimisht se:

“Kur ka arsye të motivuar se zhvillimi i një tubimi në një shesh ose vendkalim public përbën një rrezik real për sigurinë kombëtare, sigurinë publike, parandalimin e krimit, mbrojtjen e shëndetit ose të moralit ose mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të tjerëve dhe ky rrezik nuk mund të ndalohet me masa më pak shtrënguese, shefi i komisarariatit të policisë mund të ndalojë zhvillimin e tubimit, ose të vendosë për kohën dhe vendin e zhvillimit të tubimit”.

*Së pari*, në tejkalim të afateve procedurale ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 6, të Ligjit nr.8773, datë 23.4.2001, “Për Tubimet”, Shefi i Komisarariatit të Policisë, Kukës, më shkresën nr. 729/1 prot, datë 30.03.2018 i ka kthyer një përgjigje Këshillit Bashkiak Kukës, ndaj kërkesës së paraqitur për zhvillimin e tubimit. Sipas kësaj përgjigjeje nga ana e Shefit të Komisarariatit të Policisë, Kukës është konstatuar se, njoftimi i kryer për organizimin e tubimit nuk plotëson kriteret ligjore të parashikuara në ligjin “Për tubimet”, si dhe vendi i kërkuar për tubim nuk është i përshtatshëm, pasi bëhet pengesë për lëvizjen normale të shtetasve dhe të automjeteve.

*Së dyti*, megjithëse për këtë çështje në datën 30.03.2018, nga ana e Shefit të Komisarariatit të Policisë, Kukës, janë zhvilluar dy takime me Kryetarin e Këshillit Bashkiak, Kukës dhe ndërkohë e në vijim, Këshilli Bashkiak Kukës i ka dërguar një njoftim tjetër Komisarariatit të Policisë Kukës duke plotësuar disa të dhëna të nevojshme për këtë qëllim, sipas ligjit “Për tubimet”. Nuk rezulton që të jetë zbatuar detyrimi ligjor nga ana e Shefit të Komisarariatit të Policisë, Kukës, sipas të cilit ai duhet të shprehet me vendim të arsyetuar mbi këtë kërkesë. Kthimi i përgjigjes dhe kërkitimi i plotësimit të kërkesës 24 orë para zhvillimit të mitingut i ka vënë në pamundësi organizatorët që të plotësonin të metat brenda afatit 24 orësh të parashikuar nga ligji.

*Së treti*, rezulton se Këshilli Bashkiak Kukës, në përputhje me pikën 3, të nenit 5, të Ligjit “Për Tubimet”, ka plotësuar detyrimin ligjor për plotësimin e elementëve të nevojshëm të përmbajtjes së njoftimit me shkrim për zhvillimin e tubimit, ndërsa nga ana e Shefit të Komisarariatit të Policisë, Kukës, konstatohet mosveprim, pasi ky i fundit nuk ka dalë me vendim të arsyetuar mbi këtë kërkesë. Ky mosveprim efektivisht ka pasojat e tij ligjore, pasi krijon konfuzion dhe pasiguri faktike dhe ligjore, në lidhje me përcaktimet e dhëna në gërmat “a” dhe “b”, të pikës 1, të nenit 6, të Ligjit “Për tubimet”.

*Së katërti*, mosnxjerrja e një vendimi të arsyetuar mbi këtë kërkesë për tubim, nga ana e Shefit të Komisarariatit të Policisë, Kukës, identifikon një element tjetër të cënimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi i mohon

kërkuesit (Këshilli Bashkiak Kukës), të drejtën ligjore për ankim ndaj vendimit të pritshëm të Shefit të Komisarariatit të Policisë, Kukës.<sup>3</sup>

*Së pesti*, pas kërkesës së përsëritur të bazuar në plotësimin e elementëve që mungonin në njoftimin e parë të datës 28.03.2018 të Këshillit Bashkiak Kukës, përsëri nuk kemi një vendim administrativ nga ana e Shefit të Komisarariatit të Policisë Kukës, sikurse parashikohet si detyrim ligjor.

Avokati i Popullit gjen rastin që të shprehë qëndrimin e tij në lidhje me ushtrimin e të drejtës së tubimit nga qytetarët si një e drejtë themelore e individit. Rregullat procedurale që dispijlojnë apo kushtëzojnë ushtrimin e kësaj të drejte janë të përcaktuar në mënyrë të shprehur në ligj ku edhe përcaktohen kufizimet apo ndalimet shterruese të cilat nuk mund të tejkalohen në ushtrimin e së drejtës së tubimit. Kështu ky ligj pasi përcakton se çdo person ka të drejtë të organizojë dhe të marrë pjesë në një tubim paqësor dhe pa armë, parashikon gjithashtu se Policia e Shtetit garanton dhe mbron të drejtën e çdo personi për të organizuar e marrë pjesë në tubime paqësore dhe pa armë. Ndalimi dhe shpërndarja e një tubimi lejohet vetëm në rastet e parashikuara me ligj. Nga citimi i këtyre neneve del qartë se detyrat e Policisë së Shtetit në lidhje me tubimet janë së pari veprime në garantim të ushtrimit të kësaj të drejte kushtetuese dhe se ndalimi bëhet vetëm për raste thelbësisht të kufizuara e të treguara në ligj. E drejta e tubimit nuk i nënshtrohet që prej vitit 2001, vit në të cilin është miratuar ligji në fuqi, asnjë formaliteti miratimi paraprak, por vetëm njoftimit në një kohë të përshtatshme të organeve të policisë të disa të dhënave që lidhen me së shumti me zbatimin e detyrës së policisë si garantuese e ushtrimit të kësaj të drejte duke i dhënë kohe asaj për të marrë masat për mbarëvajtjen e tubimit apo protestës.

I vetmi rast në të cilin policia e shtetit ushtron të drejtën për të ndaluar një tubim ka të bëjë me çështje të sigurisë kombëtare, sigurisë publike, parandalimit të krimit, mbrojtjes së shëndetit ose moralit ose mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve dhe ky rrezik nuk mund të parandalohet me

---

<sup>3</sup> Në nenin 25, të Ligjit “Për Tubimet”, thuhet shprehimisht se: “Vendimi administrative i dhënë nga shefi i komisarariatit të policisë ose vendimet e dhëna nga oficeri përgjegjës për zhvillimin e tubimit janë të ankimeshme, sipas dispozitave ligjore në fuqi”.

masa të tjera më pak shtrënguese (neni 8 i ligjit). Në këto raste Drejtuesi i policisë mundet që eventualisht, të ndalojë zhvillimin e tubimit ose të vendosë për kohën dhe vendin e zhvillimit të tubimit.

Në kushtet e sipërcituara dhe në evidentimin e situatës faktike të këtij rasti, rezulton se drejtori i policisë vendore Kukës, jo vetëm nuk ka evidentuar asnjë arsye të motivuar se kemi qenë në një nga rastet e parashikuara nga neni 8 i ligjit, por as nuk ka ushtruar të drejtën e tij për të komunikuar me organizatorët brenda afatit të caktuar nga ligji. Gjykojmë se afati prej 24 orësh është një afat i vendosur në ligj për të bërë të mundur që organizatorët e protestës të plotësojnë kërkesën nëse ajo nuk përmbante kushtet por edhe për të disiplinuar organet e rendit që ato t'u kthejnë në kohë përgjigje organizatorëve të tubimit. Gjithashtu drejtori duke u shprehur për mosmiratim të protestës ka tejkalluar kompetencën që i njeh ligji, pasi ai ka vetëm të drejtë t'i komunikojë drejtuesit të tubimit ndalimet apo kufizimet e mundshme ose kushtet e tjera por jo të mos e miratojë protestën.

Fakti që Drejtuesi i Policisë nuk ka ushtruar të drejtën e tij për të bërë komunikimin me organizatorët e protestës brenda afatit prej 8 orësh nuk mund të interpretohet në asnjë rast kundër organizatorëve të protestës të cilët kanë bërë kërkesën, por kundër personit që nuk ka plotësuar detyrimin e tij.

Sipas drejtuesve të DVP Kukës, tubuesit nuk i janë përmbajtur kërkesës për zhvillimin e tubimit pasi nuk e zhvilluan atë në vendin e përcaktuar, i cili ishte 150 metra larg nga vendi ku kryhej pagesa e taksës. Gjatë tubimit pati veprime të cilat çuan në prishjen e objekteve nga ana e tubuesve dhe në ushtrim të së drejtës dhe kompetencës së tij ligjore, pasi tubimi devijoi nga karakteri paqësor, drejtori i policisë ka kërkuar shpërndarjen e tubimit, e cila u arrit pas shumë diskutimesh dhe negociatash. Fakti që protesta devijoi nga qëllimi i saj paqësor është evidentuar jo vetem nga raportimet e forcave të policisë por edhe nga transmetimet televizive të mediave në vend. Si rezultat i këtij fakti (i tejkallimit të së drejtës së protestës prej një pjese të demonstruesve), ka pasur dëme të shumta materiale e dëmtime të lehta shëndeti. Rendi e qetësia janë cënuar në mënyrë serioze.

Pas përfundimit të tubimit, nga Drejtoria Vendore e Policisë Kukës janë kryer veprimet e para hetimore lidhur me këtë ngjarje dhe me shkresën nr. 1276 prot, datë 31.03.2018, i janë dërguar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Kukës, materialet hetimore. (Nuk ka shënim në lidhje me orën e dërgimit të materialeve).

Nga komunikimet me prokurorin dhe me Drejtuesen e Prokurorisë, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Kukës, rezulton se pas takimit që përfaqësuesit e kësaj prokurorie kanë bërë me drejtuesit e Policisë vendore dhe pas administrimit të materialeve hetimore është vendosur lëshimi i urdhrave të ndalimit për 37 persona, ndaj të cilëve organi i akuzës kishte raporte shërbimi se ishin përfshirë në veprimtari të paligjshme, si “shkatërrim prone me zjarr”, “shkatërrim prone” dhe “kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”. Po kështu, ndaj këtyre personave kishte edhe pamjet filmike e fotografi. U cilësua se, urdhrat e ndalimeve ndaj personave në fjalë janë lëshuar në zyrën e prokurorisë, rreth orës 23:30’, dhe pas kësaj janë dërguar dorazi në Drejtorinë Vendore të Policisë Kukës, për ekzekutimin e menjëhershëm të tyre.

Në lidhje me sa më sipër, Avokati i Popullit gjen me vend të sqarojë se natyra e procesit penal në Republikën e Shqipërisë është e llojit akuzator që bazohet si e cituam më lart në prezumimin e pafajësisë dhe në përdorimin e masave shtrënguese si masa përjashtimore dhe jo si rregull. Në këto kushte është e qartë se vlerësimi i bërë nga ana e Prokurorisë në lidhje me aplikimin e masës së arrestit i nënshtrohet disa formaliteteve dhe kushteve paraprake të cilat janë të parashikuara në ligj dhe jo vetëm kaq, por vlerësimi apo jo i ekzistencës së këtyre kushteve i nënshtrohet jo vetëm vlerësimit të prokurorit që është organi i ushtrimit të akuzës, por edhe verifikimit nga ana e Gjykatës brenda afateve shumë të shkurtra të përcaktuara në mënyre të shprehur në ligj. Mosushtrimi i kompetencave të organit të akuzës apo gjykatës brenda këtyre afateve çon në humbjen e fuqisë së urdhrave të ndalimit (neni 258 dhe 259 i Kodit të Procedurës Civile)

Pra parimisht personat nuk u nënshtrohen masave të kufizimit të lirisë së tyre përpara se të shpallen fajtorë nga gjykata. Përjashtimisht, ata mund t’u

nënshtrohen këtyre masave në rast se ekzistojnë kushtet e parashikuara në nenin 253 të Kodit të Procedurës Penale.

Është pikërisht ky fakt, që në gjykimin e Avokatit të Popullit ngarkon me detyrim organin e Prokurorisë që të trajtojë e arsyetojë në urdhrin e ndalimit arsyen dhe shkakun se perse ndodhemi përpara aplikimit të një dispozite përjashtimore/shtrënguese dhe nuk po zbatohet rregulli i përgjithshëm. Për të garantuar të drejtën e lirisë personale të çdo qytetari duhet që organi i akuzës në vendimin e urdhërit të ndalimit të arsyetojë shkakun se perse duhet zbatuar ajo dispozitë në rastin konkret dhe jo të mjaftohet vetëm me vendosjen e bazës ligjore që tregon kushtet e aplikimit të përjashtimit.

Më tej, në këtë organ rezulton se nuk ka të regjistruar ndonjë kallëzim të bërë nga Drejtoria Vendore e Policisë, Kukës, ndaj organizatorëve të protestës. Nga ana tjetër rezulton se nga Këshilli Bashkiak Kukës, është bërë kallëzim ndaj drejtuesit të prokurorisë së Kukësit dhe punonjësve të Drejtorisë Vendore të Policisë Kukës, kallëzim ky i depozituar pranë Prokurorisë më të afërt, që është ajo e Tropojës.

Gjatë kryerjes së hetimeve lidhur me këtë ngjarje është konstatuar që ka patur edhe punonjës policie (nga pamjet filmike rezulton numër i kufizuar) që kanë qëlluar me gurë tubuesit dhe për këtë organi i Prokurorisë ka filluar me iniciativë, procedim penal ndaj Policisë për veprën penale të “kryerjes së veprimeve arbitrare”.

Menjëherë, sapo në Drejtorinë e Policisë Vendore kanë ardhur dorazi urdhërat e ndalimit për 37 shtetasit sipas vendimit të prokurorisë, është urdhëruar shpallja e tyre në kërkim, duke përgatitur dokumentacionin e nevojshëm ligjor dhe hedhjen e tyre në Sistemin “TIMS”. Pas kësaj janë njoftuar të gjitha Pikat e Kalimit Kufitar në vend, me qëllim kapjen e tyre nëse do të tentonin të kalonin kufirin. (Nuk disponohen kopje të urdhërave të shpalljes në kërkim dhe as interfaçe të sistemit TIMS për arsye sekreti hetimor) por shënimet për personat ndaj të cilëve janë ekzekutuar urdhrat e ndalimit janë marrë me shkrim duke këqyrur dokumentat vizualisht). Nga kjo këqyrje në DVP Kukës e Sistemit “TIMS” rezultoi se, nga 37 personat për të cilët ishin lëshuar urdhrat e ndalimit ishin kapur 23 prej tyre. Këta të

fundit ishin hedhur në sistem, në datën 01.04.2018, dhe ora e regjistrimit të tyre në sistem fillonte nga 01:50:29, deri në orën 04:11:46.

Gjithashtu, nga ky organ është organizuar puna për zbatimin e urdhërave të ndalimit duke ndarë grupet e punës. Në përbërje të grupeve të punës kanë qenë specialistë të policisë së zonës (SPZ), zonë nga e cila ishin banorë, personat përkatës në kërkim si dhe punonjës të Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë (FNSH). Veprimet e grupeve të punës gjatë zhvillimit të operacionit janë kryer me komunikime verbale. Pra nuk ka dokumentacion që të dokumentojë orën e marrjes së urdhërit të ekzekutimit të këtyre urdhrave ndalimi të Prokurorisë prej grupeve që kanë kryer ndalimet prej Drejtorit të Policisë Vendore Kukës.

Nga pyetja e dy prej SPZ-ve që kishin marrë pjesë në këto veprime u informuan se, pasi ata kishin marrë detyrën për shoqërimin në organ të personave në kërkim ishin pajisur me urdhrat e ndalimit. Sipas tyre, veprimet i kishin filluar në orët e para të mëngjesit dhe pasi u kanë shkuar në banesa, janë sjellë në mënyrë korrekte me familjarët dhe personat në kërkim, duke iu prezantuar atyre dhe duke komunikuar urdhrat e ndalimit, të lëshuar nga organi i Prokurorisë. Ata kanë deklaruar gjithashtu se nuk u janë dhënë të ndaluarve që në momentin e parë kopje të urdhrave të ndalimit pasi i dispononin vetëm në një kopje. Ata deklaruan se nuk kanë hasur në asnjë kundërshtim, si nga familjarët, ashtu edhe nga të kërkuarit e shoqëruar dhe se, në asnjë rast nuk kanë bërë kontroll banese. Gjithashtu, punonjësit e Policisë të pyetur nga ana jonë deklaruan se komunikimin me familjarët e bënin ata dhe jo punonjësit e FNSH-së, që ishin në ndihmë të tyre. Sipas tyre, për personat që mundën të gjenin, i lidhnin me pranga pasi dilnin nga banesa konform procedurës standarde dhe i hipnin në makinën e policisë, duke i shoqëruar deri në DVP Kukës, ku më pas ata janë shoqëruar nga FNSH në Drejtorinë Vendore të Policisë, Tiranë, dhe në disa Komisariate Policie, në Tiranë. Të ndaluarit e pyetur nga ana e përfaqësuesve të Avokatit të Popullit, gjatë inspektimit në Komisariatet e Policisë 1 dhe 2, në orën 12.30 te dates 1.4.2018, dëshmuan se nuk u ishte dhënë asnjë dokument shoqërimi për veprimet e kryera nga Policia, gjithashtu dhe në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë deri në orën 17.45, të ndaluarve nuk u ishte dhënë asnjë dokument për veprimet e kryera nga Policia. Në Komisariatet e Policisë 1



dhe 2 Tiranë në librat e personave të shoqëruar ishin pasqyruar hyrjet e personave të marrë në dorëzim në ora 9.00 ndërsa në DVP Tiranë nuk ishin hedhur të dhënat deri në orën 17.45. Disa prej të ndaluarve të intervistuar nga ana jonë në D.V.P. Tiranë pretenduan se punonjësit e Policisë (FNSH) gjatë ndalimit kanë vepruar me ashpërsi, në dhomat e ndalimit nuk u është dhënë ushqim gjatë ditës, gjithashtu në një rast, të ndaluarit nuk i ishin dhënë ilaçet e tensionit si i sëmurë kronik. Në vijim të veprimeve të kryera pranë Drejtorisë vendore të Policisë Tiranë, janë plotësuar të dhënat në regjistrat e shoqërimit dhe rezultoi se këta të ndaluar kanë mbërritur në këtë Drejtori nga Kukësi në orën 8:30 të mëngjesit të datës 1.4.2018 dhe se janë shoqëruar nga Forcat e Ndërhyrjes së Shpejtë. Të gjitha këto shqetësime u janë paraqitur punonjësve të Policisë dhe eproreve të tyre dhe ka pasur një reagim pozitiv për të plotësuar të drejtat e të ndaluarve. Pra deri në orën 19.00 të mbrëmjes së datës 1.4.2018 institucioni i Avokatit të Popullit ka intervistuar në Tiranë 20 nga 24 të shoqëruar dhe brenda orës 22:00 të mbrëmjes ka rivizituar personat në Komisaritet 1 dhe 3 për të garantuar që të drejtat e tyre (ndonëse me vonesë në disa raste) ishin realizuar.

Shoqërimi i tyre në organin e policisë është bërë në bazë të nenit 111, të Ligjit “Për Policinë e Shtetit” ku parashikohet se, punonjësi i Policisë bën arrestimin dhe ndalimin e personit, sipas përcaktimeve në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Ndërsa në nenin 112/2/e, të po këtij ligji është parashikuar se, në rastet e arrestimit/ndalimit, **policia evidenton për çdo person të dhënat për orën, datën dhe vendin e arrestimit, apo të ndalimit.** Pra, sapo personi kapet dhe prangoset nga punonjësi i Policisë që ka bërë kapjen në flagrancë apo ora kur bëhet ekzekutimi i urdhrin të ndalimit.

Në këtë përfundim arrihet duke iu referuar neneve 144 dhe 250, të Kodit të Procedurës Penale. Sipas këtyre dispozitave, shënimi në procesverbal i çastit (orës) së arrestimit në flagrancë, ose të ndalimit është një element i rëndësishëm, mbi bazën e të cilit fillojnë të llogariten efektet e paraburgimit. Ndërsa në bazë të nenit **258, të Kodit të Procedurës Penale, nga çasti (ora) e arrestimit ose ndalimit fillon afati i 48-të orëve, brenda të cilit prokurori kërkon vleftësimin e masës së sigurimit në gjykatën e vendit ku është kryer arrestimi, ose ndalimi.**

Nga verifikimi i bërë në Gjykatën e Shkallës së Parë, Kukës, rezultoi se kërkesa e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Kukës, për vlerësimin dhe caktimin e masave të sigurimit personal ndaj 23 shtetasve të ndaluar, ka shkuar në Gjykatën e Shkallës së Parë, Kukës, në datën 03.04.2018, ora 09:45.

Nga pyetja e personave të ndaluar rezulton se ata në fakt janë ndaluar gjatë orëve të natës pa u zbardhur dita, pra para orës 09:45. Sa më sipër, vërtetohet prej të dhënave të regjistrave të komisarivateve të policisë në Tiranë dhe të dhënave të regjistrit të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë.

Në këta regjistra siç edhe e evidentuam më lart, rezulton se personat kanë hyrë midis orës 8:00 të mëngjesit dhe 9:30 te datës 1.4.2018 në këto mjedise në Tiranë, çka do të thote se këtyre personave duke qenë se janë banorë të Kukësit e janë ndaluar në Kukës u është privuar liria minimalisht 2 orë më parë, nëse do të marrim kohën që duket për të përshkuar rrugën nga qendra e qytetit të Kukësit e deri në Tiranë.

Për më tepër është e qartë se Policisë i është dashur një kohë për të mbledhur të gjithë të ndaluarit nga banesat e tyre ku janë kapur apo ndaluar deri në Drejtorinë e Policisë Vendore Kukës.

Lidhur me Procedurën e ekzekutimit të Urdhër ndalimeve të lëshuara nga Prokuroria dhe ekzekutuar nga ora 02.00-05.00 gjatë mëngjesit të datës 01.04.2018, theksojmë faktin se grupi i eksperteve të Avokatit të Popullit, i cili shkoi menjëherë për monitorimin e situatës në Kukës pas bërjes publike nga media të ngjarjes, në pasditen e datës 31 Mars, u takua me drejtuesin e Prokurorisë Kukës dhe Drejtorin e Policisë Vendore dhe u kërkoi pa ndërhyrë në kompetencat që u njeh ligji procedural penal, të tregojnë maturi në veprime dhe të mos kryenin ndalime personash gjatë orëve të natës, për të mos cenuar dinjitetin, moralin dhe integritetin e individëve duke qenë se nuk ndodheshin në kushtet e flagrancës.

Në rekomandimet e bëra nga Avokati i Popullit në vijimësi që prej më shumë se dhjetë vjetësh, si për rastet e ankesave të trajtuara ashtu edhe nga inspektimet e bëra në organet e Policisë së Shtetit është kërkuar që, edhe në

rastet kur për personat e shoqëruar në organet e policisë vendoset arrestimi apo ndalimi, në procesverbalin e arrestimit në flagrancë ose të ndalimit duhet vihet ora e shoqërimit të tyre dhe jo ora kur përpilohet procesverbali i arrestimit/ndalimit.

Rekomandimet e Avokatit të Popullit janë bazuar jo vetëm në parimet universale të së drejtës dhe në parimet e përgjithshme të së drejtës tonë penale, por edhe në dispozitat konkrete të Kodit të Procedurës Penale respektivisht nenet 144, 250 dhe 259 të tij.

Është e nevojshme që të sqarojmë se këto rekomandime janë vlerësuar të drejta dhe janë pranuar nga Policia e Shtetit. Për këtë fakt i referohemi edhe përgjigjeve të dërguara kohët e fundit nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit respektivisht me shkresat nr. 12/1 prot, datë 13.02.2018 dhe nr. 267/1 prot, datë 07.03.2018.

Sjellim në vëmendje se disa nga këto rekomandime janë bërë në muajt e fundit dhe për koençidencë njëri prej tyre i është drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë Kukës në datën 29.12.2017. Por pavarësisht sa më sipër të dhënat e pasakta apo të munguara pjesërisht në disa regjistra në vendin ku janë mbajtur personat e ndaluar janë nën administrim të Drejtorisë së Policisë vendore Tiranë.

Ndërkohë, të shoqëruarit në D.V.P.Tiranë pretenduan se që nga koha e marrjes nga banesa (ekzekutimit të urdhërave të ndalimit) dhe deri rreth orës 18.00, nuk u ishte dhënë ushqim.

Në Drejtorinë Vendore të Policisë, Tiranë, në të cilën është shkuar rreth orës 16.30'', u gjetën 12 persona të shoqëruar, të cilëve nuk u ishte dhënë asnjë lloj dokumenti. Në kohën e shkuarjes së grupit të punës, O.P.GJ. i D.V.P.Kukës ishte duke përpiluar procesverbalet e ekzekutimit të urdhërave të ndalimit dhe të kontrollit personal. Nga deklarimet e marra prej 6 të ndaluarve, ata pretenduan gjithashtu se O.P.Gj nuk u kishte dhënë letrën e të drejtave të personit nën hetim.

Në Komisariatit e Policisë nr.3 Tiranë, ku u shkua rreth orës 20.30 u gjetën katër persona të ndaluar dhe nga pyetja e tyre rezultoi se ishin pajisur me

dokumentacion, si urdhër ndalimi të prokurorit, proces verbal i ekzekutimit të urdhërit, kontrollit personal dhe letra me të drejtat e personit nën hetim.

Ndërsa rreth orës 21.30 u shkua përsëri në Komisarriatin e Policisë nr.1 Tiranë, dhe u konstatua se nga katër personat e shoqëruar, tre prej tyre ishin ndaluar dhe tjetri ishte liruar pas mbarimit të afatit të shoqërimit prej 10 orësh. Tre të ndaluarve u ishin dhënë dokumentet e nevojshme për ndalimin e tyre.

Nga pyetja e të ndaluarve rezultoi se vetëm njëri prej tyre dhe konkretisht shtetasi V.L, pretendoi se gjatë protestës ishte goditur nga punonjësit e Policisë së Ndërhyrjes së Shpejtë, me shkop gome dhe gurë, por ai nuk kishte ndonjë shenjë dhune në trup.

Nga ana tjetër, numri i forcave të policisë në qytetin e Kukësit në datën 1.4.2018 në vlerësimin tonë ka qenë i ekzagjeruar e si i tillë nuk mund të ketë kontribuar në uljen e tensioneve.

Nga tërësia e veprimeve të kryera nga strukturat e Policisë së Shtetit vlerësojmë se nuk ka pasur veprime të kryera me dashje apo frymë kundër protestuesve nga ana forcave të Policisë së Shtetit, pavarësisht disa shkeljeve procedurale, apo demonstrimi të panevojshëm i forcës, evitimi i të cilave do të duhet të ishte bërë nga forcat e Policisë së Shtetit.

Pavarësisht sa më sipër mendojmë që në lidhje me këtë fazë të veprimeve të kryera nga strukturat e Policisë së Shtetit, ka nevojë për të përmirësuar procedurat dhe zbatimin efektiv të tyre në mënyrë që të garantohen të drejtat e ligjshme të qytetareve.<sup>4</sup>

#### **IV. Veprimet e organit të Prokurorisë**

##### ***Ushtrimi i funksioneve të prokurorit***

Në nenin 3 të Ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” thuhet se: “*Prokuroria ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, merr masa*

---

<sup>4</sup> Hartuesit e këtij materiali sqarojnë se ky material mund të përmbajë persertije dhe se persertitja e fakteve dhe qartësimi i situatave është bërë për ta bërë me lehtësi të lexueshem materialin. Gjithashtu ai është një i tërë dhe ndarja në tituj është bërë për lehtësi leximi.

*dhe mbikëqyr ekzekutimin e vendimeve penale, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e Policisë Gjyqësore, si dhe kryen detyra të tjera të caktuara me ligj”.*

Kurse në pikën 1, të nenit 304, të Kodit të Procedurës Penale, **“Veprimtaria Hetimore e Prokurorit”**, thuhet se:

*“Prokurori drejton veprimtarinë hetimore dhe kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm”, çka do të thotë se **ka qënë detyrimi i prokurorit për të ndjekur në vazhdimësi veprimet e kryera nga Policia Gjyqësore, duke filluar me ekzekutimin për zbatim të urdhërave të ndalimit si dhe delegimin për kryerjen e veprimeve hetimore.***

Pas ngjarjes së ndodhur, prokurorët bazuar në nenin 253 të Kodit të Procedurës Penale, më datë 31.03.2018, ora 23.00, kanë përpiluar 37 urdhëra ndalimi për qytetarët protestues, si të dyshuar për kryerjen e veprave penale **“Kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik”** dhe **“Shkatërrim i pronës**, parashikuar nga nenet 236/2 e 150 të Kodit Penal.

Nga studimi i urdhërave të ndalimit, tek pjesa arsyetuese organi procedues, jo vetëm që nuk ka paraqitur asnjë arsye ligjore të ndalimit të personave, por gjithashtu nuk ka vërtetuar asnjë kusht për ekzistencën e shkaqeve të bazuara për rrezikun e ikjes për secilin prej tyre. Edhe në kërkesën e saj për vleftësimin e ndalimeve dhe caktimin e masës së sigurimit, zhvilluar më datë 04.04.2018, organi i akuzës nuk paraqiti prova që të vërtetonin kushtet e rrezikut të ikjes për çdo person të ndaluar.

Nga hetimi i pavarur i Avokatit të Popullit dhe zhvillimit të shqyrtimit gjyqësor në seancën e vleftësimit të ndalimit, u evidentua fakti se, disa nga personat e ndaluar kishin shkaqe dhe arsye të tilla objektive që as mund të mendonin për t’u larguar, pra të përbënin rrezik për ikje, siç ka pretenduar organi i Prokurorisë.

Kështu, shtetasi A.D., paraqitet si person me probleme të shëndetit mendor; shtetasi L.R., ka vajzën e mitur 12 vjeç me sëmundje celebrale. Ai posedon një mjet me të cilin ushtron aktivitetin e tij privat dhe për arsye frike se mos ia vjedhin fle natën në të. Kurse, shtetasi A.D., i cili është invalid i grupit të

dytë pasi paraqitet me sëmundje zemre, në seancë ngriti pretendimin se, Policia Gjyqësore i kishte bllokuar librezën e invaliditetit, e për rrjedhojë nuk mund ta paraqiste si dokument para Gjykatës.

Punonjësit e Avokatit të Popullit në Kukës, janë informuar nga Prokurorët se ata kishin marrë deklarime të punojësve të Policisë së Shtetit, të dëmtuar gjatë protestës, si dhe për këtë kishin përpiluar vendimet për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor.

Por nga hetimi i pavarur administrativ rezultoi se disa protestues në gjendje të lirë si U.L., G.B., apo dhe i ndaluar V.L, kishin pretendime për dëmtime të shkaktuara nga punonjësit e Policisë së Ndërhyrjes së Shpejtë, dhe për mjekimin e të cilave kishin shkuar në urgjencën e Spitalit Rajonal Kukës. Nga ana tjetër shtetasja S.R., ka pretenduar se punonjësit e Policisë kur kanë shkuar në banesën e saj për të ndaluar bashkëshortin L.R., kanë kontrolluar në banesë, si në dhomën ku ndodhej vajza e sëmurë, ashtu edhe nëpër raftet e kuzhinës.

Për një hetim të gjithanshëm dhe objektiv i sugjeruam organit të Prokurorisë kryerjen e disa veprimeve hetimore si, marrjen e deklarimeve të personave të dëmtuar, pjesëmarrës në protestë, apo dhe të ndaluar, të këqyrë apo administrojë regjistrat që disponon urgjenca e Spitalit Rajonal Kukës, për vizitat dhe mjekimin e protestuesve të dëmtuar, deri në përpilimin e vendimit për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor për dëmtimet e shkaktuara. .

Ky detyrim vjen dhe nga kërkesa e parashikuar në pikën 1, të nenit 304, të Kodit të Procedurës Penale (*Ligji nr.35/2017, “Për disa ndryshime në ligjin nr.7905 atë 21.03.1995 Kodi i Procedurës Penale, të ndryshuar*), ku thuhet se: *“Prokurori kryen hetime edhe për verifikimin e fakteve ose rrethanave në favor të personit, ndaj të cilit zhvillohen hetime”*.

Në këtë kontekst duhet të ishin hetuar nga ana e organit të akuzës edhe pretendimet në lidhje me orën e saktë të ndalimit të tyre dhe garantimin e të drejtave të parashikuara nga ligji procedural penal.

### ***Veprimet e kryera nga Policia Gjyqësore***

Me marrjen e Urdhërave të Ndalimit të personave nga Prokuroria, Policia Gjyqësore e Drejtorisë Vendore të Policisë, Kukës, dhe Policisë Gjyqësore të Komisariateve Nr.1, Nr.2 dhe Nr. 3, Tiranë, ka filluar ekzekutimin, duke i pasqyruar ato në procesverbalet përkatëse, të datës 01.04.2018, në intervalin nga ora 10.20'' deri më 12.00''.

Nga këqyrja e përmbajtjes së procesverbaleve për ekzekutimin e urdhërit të prokurorit konstatohet se ato kanë të meta e mangësi të theksuara dhe se në tërësinë e tyre këto procesverbale nuk janë hartuar në përputhje me parashikimet e nenit 255/1 të Kodit të Procedurës Penale. Konkretisht këto mangësi konsistojnë në:

- a. pasqyrimin stereotip në përmbajtje, por me emra të ndryshëm të dy Oficerëve të Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Kukës. Kështu, Në procesverbalin e ekzekutimit të urdhërit të prokurorit për shtetasin A. T., datë 01, muaji Prill 2018, ora 12.00, është paqyruar emri i S. M., Oficer i Policisë Gjyqësore, kurse në fund të proces verbalit ai rezulton si i pranishëm dhe A. H., Oficer i Policisë Gjyqësore i cili ka mbajtur procesverbalin. Në të gjitha procesverbalet e ekzekutimit nuk saktësohet se çfarë urdhëri të prokurorit po ekzekuton Policia Gjyqësore, (pra atë të ndalimit).
- b. mospasqyrimin e neneve përkatëse të Kodit të Procedurës Penale.
- c. mosevidentimin e orës së saktë, reale kur është ekzekutuar dhe përpiluar proces verbali nga Policia Gjyqësore, për secilin nga 23 shtetasit e ndaluar.
- d. Nuk është treguar vendi në të cilin atyre u është privuar liria;
- e. Nuk rezulton që të ndaluarve t'u jetë komunikuar karta e të drejtave; e drejta për t'u mbrojtur me Avokat; e drejta për të mos bërë deklarime pa praninë e avokatit pasi ato mund të përdoren kundër tij.
- f. Nuk është pasqyruar data, ora dhe emri i oficerit të Policisë Gjyqësore që ka bërë arrestimin e tij, por emrat e personave që në një orë më të vonë (edhe kjo orë, e pasaktë) kanë njoftuar formalisht urdhërin e arrestit;

Të 23 personave të ndaluar, nga Policia Gjyqësore, nuk u është dhënë kopje e urdhërit të prokurorit për ndalimin e tyre, në momentin e vendosjes së prangave, në orët e para të mëngjesit, të datës 01.04.2018..

Nga Policia Gjyqësore nuk është respektuar edhe kërkesa e parashikuar në pikën 4, të nenit 255, të Kodit të Procedurës Penale, për njoftimin e familjarëve të të ndaluarve.

Gjatë pyetjes së të ndaluarve ata deklaruan se, pas vendosjes së prangave në banesat e tyre, Policia Gjyqësore nuk i ka vënë në dijeni se në cilat ambiente sigurie të Policisë së Shtetit do t'i dërgonin, ndërsa familjarët e tyre shpjeguan se atyre u kanë thënë të paraqiten në Drejtorinë Vendore të Policisë, Kukës në orën 8 të mëngjesit.

Nga leximi i procesverbaleve rezulton se oficerët që kanë zbatuar këto urdhra arresti kanë pasur njohuri të pamjaftueshme të ligjit procedural penal. Këta procesverbale në kundërshtim me ligjin citojnë se një kopje e procesverbalit i njoftohet Prokurorit të çështjes brenda 48 orëve.

Përpos faktit që ligji shprehimisht parashikon njoftimin në mënyrë të menjëhershme të këtij procesverbali prokurorit, afati “brenda 48 orësh” është afati që ka prokuroria për të vendosur nëse do të dërgojë për vleftësim të masës së arrestit të ndaluarit në Gjykatë apo jo. Pra nëse prokurori ska procesverbalin, ai vihet në pamundësi për të plotësuar detyrimet e tij ligjore.

Duke analizuar në tërësi veprimet apo mosveprimet e Policisë Gjyqësore, konstatojmë një sërë mangësish dhe shkeljesh procedurale, në cënim të të drejtave të shtetasve të ndaluar, për një proces të rregullt ligjor.

Organi i Prokurorisë nuk ka bërë asnjë përpjekje për të parë dhe nuk ka ndjekur zbatimin me korrektësi të ekzekutimit të urdhërave të ndalimit nga Policia Gjyqësore, duke cënuar garancitë procedurale të personave nën hetim.

Për më tepër, edhe pse ka pasur për detyrë të garantojë e sigurojë evidentimin e saktë të kohës së arrestit është mjaftuar me një vlerësim tërësisht



sipërfaqësor të dokumentacionit që asaj i është vënë në dispozicion nga oficerët e policisë gjyqësore. Vetë këto procesverbale ndonëse me parregullsi, tregojnë se janë mbajtur në Tiranë, në një orë të caktuar, e për çdo anëtar të organit të akuzës është e qartë se ora e procesverbalit nuk përputhet me orën e privimit të lirisë dhe se ora e privimit të lirisë nga ky dokument (sado i pasaktë) do të duhej të ishte të paktën 2.5 orë para orës së mbajtjes së procesverbalit që do të ishte në rastin më të mirë koha që do t'i ishte dashur secilit prej tyre të udhëtonte për të qenë në Tiranë duke nisur nga ora 10:00 e vijim e datës 1.4.2018, kohë nga e cila rezultojnë të bëra komunikimet.

Avokati i Popullit vlerëson se evidetimi dhe mbajta me saktësi e procesverbaleve siç parashikohet nga Kodi i Procedures penale si dhe i regjistrave të Policisë është i vetmi mjet për të garantuar zbatimin e garancive që ligji u ka dhënë të ndaluarve.

Ata janë qartësisht në pamundësi për të vertetuar orën në të cilin atyre u është privuar liria e ndaj këto veprime duhet të kryhen me saktësi prej oficerëve të Policisë Gjyqësore nën urdhrat dhe verifikimin e prokurorit i cili ka për detyrë të verifikojë e hetojë për pretendimet e ligjshme të të ndaluarve.

Organi procedues të njëjtin qëndrim ka mbajtur dhe në seancën e vleftësimit të ndalimit dhe caktimit të masës së sigurimit, kur është vënë në dijeni nga të ndaluarit dhe përfaqësuesit e tyre ligjorë, për faktin se, ata janë prangosur në orët e para të mëngjesit të datës 01.04.2018, kohë në të cilën dhe është ekzekutuar urdhëri i prokurorit dhe jo në orët e paqyruara në proces verbalet përkatëse nga ana e Policisë Gjyqësore. Mbi këtë bazë edhe kërkesa e prokurorit është dërguar në gjykatë në orën 09.45, të datës 03.04.2018.

Për sa sipër arrihet në përfundimin se, *Prokuroria ka cënuar të drejtat e të ndaluarve duke llogaritur si kohë ndalimi orën e ekzekutimit të urdhërave të ndalimit datë 01.04.2018, pas orës 10.20-12.00, kohë e cila siç përmendëm nuk është koha faktike e ndalimit.*

Nga ana tjetër theksojmë se, *Afati i paraqitjes së kërkesës për vlerësimin e ndalimit fillon nga çasti kur të ndaluarit i hiqet liria, kudo qoftë ai, dhe jo*

*nga çasti i mbylljes në dhomat e paraburgimit, në rastin konkret me vendosjen e prangave në banesë, pas orës 03.00 të datës 01.04.2018.*

Qëndrimi i Avokatit të Popullit është i pandryshuar në kërkesën ndaj organeve ligjzbatuese dhe të drejtësisë për garantimin e të drejtave të palëve në procesin penal.

## **V. Procesi gjyqësor**

Si rrjedhojë e veprimeve paraprake proceduriale të kryera nga ana e Policisë së Shtetit dhe Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës, në datën 04.04.2018, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, është zhvilluar seanca gjyqësore për dhënien e masës së sigurimit, ndaj 23 personave të ndaluar me Urdhër të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Kukës, të akuzuar për veprat penale të “Kundërshtimit të punonjësit Policisë së Rendit Publik” dhe “Shkatërrimit të pronës”, të parashikuara përkatësisht, në nenin 236/2, nenin 150 dhe nenin 25, të Kodit Penal, kryesuar nga gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Kukës, znj. Alma Ahmeti.

Duke qenë në monitorim të vazhdueshëm të të gjithë procesit që nga fillimet e tij, në këtë seancë gjyqësore kanë qenë të pranishëm, si dëgjues, dy ndihmëskomisionerë të institucionit të Avokatit të Popullit.

Që në momentet e para, përfaqësuesit e institucionit të Avokatit të Popullit, kanë vërejtur një situatë të pazakontë në ambientet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi kanë konstatuar konfrontim fizik dhe verbal të disa deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, të cilët kërkonin të merrnin pjesë si dëgjues në këtë seancë gjyqësore, me punonjës të Policisë së Shtetit, të caktuar për ruajtjen e sallës respektive në gjykatë ku do të zhvillohej kjo seancë.

Kjo situatë konfrontimi ka ndodhur në hyrjen e sallës ku do zhvillohej gjykimi. Sipas konstatimit të kryer, rezultoi se punonjësit e Policisë së Shtetit nuk lejonin këta deputetë që të futeshin në sallën e gjykimit, si dëgjues. Ky ndalim ndodhte jo vetëm për deputetët, por dhe për persona të tjerë, të cilët

kishin shfaqur interes për të marrë pjesë në seancën e gjykimit. Justifikimi i përdorur nga ana e punonjësve të Policisë së Shtetit ishte fakti se nga ana e Gjykatës ishte marrë vendim për zhvillimin e kësaj seance gjyqësore me dyer të mbyllura.

Nga përdorimi i forcës midis palëve u thye dera e sallës gjyqit dhe kjo gjendje ka vazhduar për një kohë të gjatë, deri sa u ndërmjetësua nga vetë palët dhe në përfundim u vendos që, deputetët përkatës të Kuvendit që kishin shfaqur interes për të qënë prezent në seancë si dëgjues, të lejoheshin që të ishin të pranishëm gjatë zhvillimit të kësaj seance gjyqësore.

Një konstatim tjetër i përfaqësuesve të institucionit të Avokatit të Popullit është se, media nuk është lejuar në sallën e gjyqit gjatë zhvillimit të seancës gjyqësore. Ajo u lejua vetëm gjatë shpalljes së vendimit.

Është konstatuar se, nga ana e Gjykatës nuk është komunikuar paraprakisht një vendim për mënyrë se si do të zhvillohej kjo seancë, si një element i procedurës së zhvillimit të gjykimit, mbi bazën e të cilit vendosej nëse kjo seancë gjyqësore do të ishte publike, apo me dyer të mbyllura.

Ndërkohë, nga dokumentacioni i disponuar në lidhje me këtë çështje, vërehet se në vendimin gjyqësor nr. 39329, datë 04.04.2018, cilësohet se kjo seancë gjyqësore ka qenë publike, çka bie ndesh me situatën e krijuar para zhvillimit të kësaj seance. Nuk rezulton nga aktet as të ketë pasur kërkesë nga organi i akuzes dhe as të jetë marrë ndonjë vendim nga ana e Gjyqtarës, për gjykimin e seancës gjyqësore me dyer të mbyllura.

**Kjo situatë e krijuar bie ndesh me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale për zhvillimin e seancës me dyer të hapura dhe pikërisht nenet 339 dhe 340, të Kodit të Procedurës Penale, që parashikojnë se në parim, seancat gjyqësore janë publike.**

*Nga ky konstatim i parë, duhet theksuar se, seanca e hapur gjyqësore përbën një tipar thelbësor të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.* Karakteri i hapur i procedimeve para organeve gjyqësore, sipas nenit 6/1 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), mbron palët ndërgjyqëse

kundrejt ushtrimit të drejtësisë në fshehtësi dhe pa mbikëqyrje publike. Publiciteti në ushtrimin e drejtësisë kontribuon në përmbushjen e synimit për një proces të rregullt ligjor.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe KEDNJ kanë përcaktuar standarde të qarta për pjesëmarrjen në gjykim dhe zhvillimin e procesit të rregullt ligjor në mënyrë të atillë që t'u garantohet të gjitha palëve, mbrojtje efektive në të gjitha shkallët e gjykimit, prandaj prekja e tyre, përbën shkelje të të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Në raste të tilla nuk duhet mënjanuar interesi publik për të bërë drejtësi në përputhje me standartet.

Në sallën e gjyqit ka patur një prezencë të madhe të forcave të policisë (mbi 30 punonjës të policisë të armatosur). Megjithëse prezenca e punonjësve të Policisë së shtetit në sallën e gjyqit ka qënë konform numrit të lejuar të parashikimeve ligjore në fuqi, vlerësojmë se kjo prezencë faktike përbënte premisë për krijimin e një ngarkese psikologjike ndaj personave që ndiqnin seancën gjyqësore dhe që në fakt mund të rezultonte edhe në krijimin e një ambienti në dukje jo të përshtatshëm për komoditetin dhe qetësinë e nevojshme vlerësuese dhe analizuese, që duhet t'i sigurohet gjyqtarit për zhvillimin e një seance sa më normale.

Edhe gjatë zhvillimit të kësaj seance gjyqësore është vënë re se, janë gjykuar njëherazi 23 persona dhe realisht për kohën e zhvillimit të seancës nuk mund të arrihet në konkluzionin se Gjykata është thelluar sa duhet dhe ka marrë parasysh siç duhet specifikën e çdo personi në gjykim, sikundër mund të thuhet se baza e gjykimit është mbështetur vetëm tek të dhënat e sjella nga ana e organit të prokurorisë.

Efektivisht duke u nisur nga ky numër personash në gjykim dhe kohës fizike që Gjykata ka “konsumuar”, për të marrë vendimin për dhënien e masës së sigurimit, ndaj 23 personave të ndaluar me Urdhër të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Kukës, mund të arrihet në konkluzion se, Gjykata nuk është thelluar në pjesën procedurale të hetimit gjyqësor, pasi nuk ka marrë realisht parasysh dhe nuk ka vlerësuar pretendimet dhe provat e personave të ndaluar apo edhe të përfaqësueve të tyre ligjore. Baza e këtij vlerësimi të kyrrer nga ana e Gjykatës kanë qënë, sikundër rezulton në vendimin nr. 39329, datë

04.04.2018, vetëm aktet dhe provat e sjella nga ana e organit të Prokurorisë. Sikundër ka rezultuar seanca gjyqësore ka zgjatur rreth 3 (tre) orë dhe pothuaj gjysma e kësaj kohëzgjatjeje (pra 1.5 orë), ka shërbyer për Gjyqtaren vetëm për të lexuar dispozitivin e vendimit të marrë, në përfundim të kësaj seance. Me një përlllogaritje të thjeshtë, del se gjyqtari që ka zhvilluar senacën ka pasur më pak se 4 (katër) minuta në dispozicion, për të trajtuar e zhvilluar hetimin gjyqësor për çdo person të ndaluar, ndaj të cilit kërkohej dhënien e masës së sigurimit.

***Nisur nga këto konstatime, sjellim në vëmendje faktin se, jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë e ka pranuar të drejtën e mbrojtjes dhe të drejtën për t'u dëgjuar si elementë të rëndësishëm të procesit të rregullt ligjor duke i trajtuar këto të drejta të lidhura ngushtësisht me njëra-tjetrën.***

Këto dy të drejta, në unitet edhe me të drejta të tjera, kanë qëllim garantimin e një procesi gjyqësor ku individit i krijohen mundësitë që para marrjes së vendimit gjyqësor të dëgjohet realisht mbi thelbin e çështjes. Në këtë mënyrë garantohet edhe zbatimi i një parimi thelbësor në procesin gjyqësor, ai i kontradiktoritetit.

Nëpërmjet pjesëmarrjes dhe krijimit të kushteve për t'u dëgjuar, individëve u krijohen mundësi të barabarta për deklaratimet e tyre, për parashtrimin e fakteve, provave e vlerësimeve ligjore. Kushdo, qoftë në procesin penal, qoftë në procesin civil, duhet të ketë mundësinë t'i paraqesë gjykatës, në mënyrën e duhur, çështjen e vet, në kushte që nuk e vendosin atë në situatë dukshëm të pafavorshme në raport me palën kundërshtare.

***E drejta për tu dëgjuar nga gjykata është një element i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor.*** Ajo lidhet kryesisht me të drejtën për të bërë kërkime/parashtrime dhe për të marrë përgjigje për to. Kërkesat e nenit 42, të Kushtetutës dhe nenit 6, të KEDNJ, të marra në tërësi, kanë për qëllim që t'i garantojnë kujtdo që pretendon se i janë shkelur të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj, në radhë të parë ndjekjen e çështjes në gjykatë.

Në këtë kuptim, pjesëmarrja në gjykim është një e drejtë e pamohueshme për faktin, se kjo pjesëmarrje, shërben për të mbrojtur në substancë të drejtën që pretendohet si e shkelur. Sipas një vendimi të hershëm të GJEDNJ, do të ishte e pakuptimtë që neni 6/1 i Konventës të përshkruante me detaje garancitë procedurale që u ofrohen palëve në proces dhe të mos mbronte në radhë të parë atë që bën në të vërtetë të mundur që të përfitohet nga këto garanci: pra, pjesëmarrjen në gjyq dhe dëgjimin nga gjykata.

Gjykata Kushtetuese në praktikën e saj lidhur me këto elementë të procesit të rregullt ka elaboruar gjerësisht standartet që duhet të mbajnë parasysh gjykatat e zakonshme gjatë gjykimeve sidomos atyre penale. Një nga çështjet më të rëndësishme lidhur me këtë parim ka qenë edhe mënyra e marrjes së provave, nga gjykata.

Gjykata Kushtetuese e ka vlerësuar si të rëndësishëm procesin e mbledhjes dhe marrjes së provave nga gjykatat, pasi gjatë këtij procesi vendoset fati i përfundimit të gjykimit në tërësi. Në këtë fazë i duhet dhënë mundësia të pandehurit të jetë prezent, vetë ose nëpërmjet mbrojtësit, t'i kundërshtojë ato ose të debatojë rreth tyre etj.

Këtë të drejtë Gjykata Kushtetuese e ka lidhur, midis të tjerave, edhe me garancinë që jep neni 32/2 i Kushtetutës, ku parashikohet se askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme. Ky parim i rëndësishëm është trajtuar nga jurisprudenca shqiptare dhe ajo e Gjykatës së Strasburgut si pjesë përbërëse e procesit të rregullt ligjor dhe veçanërisht në drejtim të respektimit të së drejtës për t'u mbrojtur, e cila kërkon që i akuzuari të ketë mundësitë e duhura për të njohur dhe komentuar çdo provë që i paraqitet gjykatës.

Në bazë të kërkesave të KEDNJ dhe interpretimit të saj nga GJEDNJ, gjykata e ka për detyrë të vlerësojë në tërësi, nëse procedura lidhur me mënyrën se si u siguruan provat ishte e drejtë. Mënyra e marrjes së provave ka rëndësi thelbësore për zhvillimin e drejtë të procesit penal.

***Barazia e armëve dhe kontradiktoriteti në procesin penal*** përbëjnë elementë të rëndësishëm e thelbësorë të procesit të rregullt në kuptimin kushtetues.

Synim kryesor është realizimi i një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata me objektivitet e paanësi.

Këto kërkesa kushtetuese e ligjore janë në funksion të mbrojtjes sa më efektive të të pandehurit, pasi përballë tij qëndron vetë shteti, i përfaqësuar në procesin penal nga prokurori që paraqet dhe mbron akuzën kundër tij.

Është detyrë e shtetit që të marrë masat e duhura për të garantuar pjesëmarrjen në procesin penal të personit të akuzuar ose mbrojtësit ligjor, qoftë edhe atij të caktuar kryesisht. GJEDNJ ka theksuar disa herë se kërkesat e mësipërme duhet të respektohen jo vetëm në shkallën e parë, por edhe në shkallët e tjera të gjykimit, veçanërisht në rastet kur në këto gjykime parashikohet edhe zhvillimi i debatit me gojë.

Sipas Gjykatës Kushtetuese, në procesin penal, barazia e armëve, kontradiktoriteti dhe lidhur ngushtë me këto, mbrojtja e të pandehurit, e garantuar shprehimisht në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ, përbëjnë në vetvete elementët më të qenësishëm e thelbësorë të procesit të rregullt ligjor.

Për respektimin e këtyre elementeve, gjykatat duhet të përmbushin me rigorozitet një sërë detyrimesh, mes të cilave, rëndësi të veçantë paraqet sipas rastit, edhe njoftimi i të pandehurit apo mbrojtësit të tij ligjor për akuzën, ankimin, rekursin, ditën dhe vendin e gjykimit të çështjes. Synim kryesor është realizimi i një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata me objektivitet e paanësi.

Barazia e armëve në proces fillon që në momentin e hetimit në çështjet penale. Ajo duhet respektuar në të gjitha fazat e hetimit gjyqësor si dhe në ushtrimin e të drejtës së ankimit në instancat më të larta gjyqësore.

Në përfundim të gjykimit, Gjykata vendosi të deklarojë të ligjshëm ndalimet e lëshuara nga organi procedues, përkatësisht Prokuroria e Rrethit Gjyqësor, Kukës, duke vendosur masë sigurimi me arrest në burg për 9 persona dhe për

2 persona, masë sigurimi me arrest në shtëpi. Ndërsa personat e tjerë janë liruar me detyrim paraqitje në Policinë Gjyqësore, duke urdhëruar lirimin e tyre të menjëhershëm.

Sipas Gjykatës Kushtetuese, “Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë, pasi duhet qartësuar që, pavarësia dhe diskrecioni i gjykatës kanë një kufizim, nënshtrimin ndaj Kushtetutës dhe ligjeve. Ky kufizim qëndron edhe në parashikimin e një sërë kontrollesh të brendshme ndaj një procesi.

Vendimi, siç u përmend më sipër, mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse. Dhe që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në bërjen e një zgjedhje ndërmjet disa mundësive. Pra, gjyqtari duhet të shpjegojë arsyet e vendimeve të tij, duke iu referuar fakteve për të cilat është zhvilluar procesi, ligjeve të zbatueshme dhe kërkesave të ndryshme të palëve” (Vendimi 11/2008).

Pavarësisht ndryshimeve që kanë ndodhur në Kodin e Procedurës Penale, mbi gjykimin e disa personave njëherësh në të njëjtën senacë gjyqësore, sikurse ka ndodhur edhe në këtë rast, duhet vënë dukje fakti se, **kjo mënyrë gjykimi nuk mund të sigurojë në situatën faktike (kur ka një numër të lartë të ndaluarish) efektivitetin e gjykimin, si dhe kontradiktorialitetin e nevojshëm në gjykimin e ndaj ka nevojë për t’u vlerësuar një ndryshim legjislativ në këtë drejtim.**

Gjykata në këtë rast dhe në referencë të të gjitha konstatimeve të bëra, rezulton se nuk ka hetuar lidhur me provat e paraqitura për çështjen në gjykimin, nga ana e personave të ndaluar mbi bazën e urdhëve përkatës të Prokurorisë. Në këto rrethana, mund të thuhet se pretendimet e këtyre palëve apo edhe provat e paraqitura nga organi i Prokurorisë (shiko më lart trajtimin për të dhënat që përmban procesverbali i komunikimit të urdhërit të ndalimit) në gjykimin nuk janë marrë aspak në konsideratë nga ana e Gjykatës, e cila ndër të tjera në vendim nuk ka argumentuar faktin se, përse nuk është pranuar ora e pretenduar e ndalimit, e pretenduar si e tillë nga ana e personave të ndaluar.



Të gjithë këta elementë të konstatuar të seancës gjyqësore të zhvilluar në datën 04.04.2018, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, flasin për cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, penal.

E drejta për t'u gjykuar para një gjykate të pavarur dhe të paanshme, në kuptim të ushtrimit dhe realizimit të një procesi të rregullt ligjor, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo duhet të krijojë perceptimin dhe të shihet se po bëhet.

Për të mënjanuar çdo dyshim në asnjë rast Avokati i Popullit nuk merr përsipër e as mëton të ndërhyjë në kompetencat dhe në vendimarrjen e organit të akuzës apo Gjykatës, dhe se evidentimet e mësipërme i kemi bërë në kuadër të garantimit të një procesi të rregullt ligjor e për të garantuar të drejtat dhe liritë e individit që atyre u garantohen me ligj.

Ne vlerësojmë t'ua bëjmë me dije këto konstatime organeve ligjzbatuese për të bërë të mundur që ata të përmirësojnë punën në ato aspekte ku ka nevojë për përmirësim e në rastin konkret mangësitë e evidentuara duhen trajtuar me vëmendje të veçante për të garantuar në mënyrë të vazhdueshme besimin që qytetarët kanë e duhet të kenë në këto organe.

## **VI Konkluzione :**

- Mirëqeverisja është është një vlerë e natyrshme dhe vitale në një demokraci ku respektohet shteti i së drejtës dhe ku të drejtat e njeriut janë kryefjala e çdo sipërmarrjeje të ushtrimit të pushtetit shtetëror. Shteti duhet të ketë dhe të tregojë një standard më të lartë të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të njeriut, në raportet që ai krijon me individin dhe ky është një standard më vete i mirëqeverisjes.
- Respektimi i së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor mbetet një nga elementët kyç në çdo proces vendimmarrës të organeve shtetërore, gjë që ngërthen në vetvete një sërë të drejtash të tjera, shkelja e të cilave cenon rëndë besueshmërinë dhe legjitimitetin e këtyre organeve. “Prezumimi i pafajësisë” kërkon një proces shterues dhe të plotë ligjor, ku çdo hap dhe hallkë procedurale plotëson

“mozaikun e nevojshëm” ligjor të bazueshmërisë së masave dhe vendimeve të dhëna, në procesin penal.

- Avokati i Popullit është i qëndrimit se vendimi i Gjykatës, duhet të arsyetohet në mënyrë bindëse duke shmangur dhe larguar paqartësitë dhe si pasojë, të krijojë sigurinë e vazhdimësisë së normalitetit duke përjashtuar kështu efektet negative që mund të krijohen në rastin e kundërt. Vetëm kështu sistemi i drejtësisë do të mund të krijojë besimin e munguar në sytë e publikut.
- Masat administrative për trajnimin e forcave të Policisë për të njohur, respektuar dhe garantuar përcaktimet ligjore për tubimet do të shërbejnë për mënjanimin e moszbatimit korrekt të ligjit në rastin më të mirë dhe/ose shkelje të të drejtave të qytetarëve në rastin më të keq. Ngjarje të tilla ndikojnë në çdo rast jo vetëm në liritë e të drejtat e individit por edhe në perceptimin dhe besimin që ka publiku te forcat e Policisë. Avokati i Popullit vlerëson se besimi në organet e ruajtjes së rendit publik është një e mirë publike; rritja e këtij besimi është rezultat i punës dhe përpjekjeve të vetë këtyre organeve në radhë të parë dhe sigurisht në sajë të bashkëpunimit dhe me vendet partnere, ndaj ulja e këtij besimi për shkak të veprimeve neglizhente fatkeqësisht sjell një dëm të madh në perceptimin që qytetarët kanë për mënyrën e zbatimit të ligjit.
- Mungesa e besimit dhe problemet në sistemin e drejtësisë sollën si nevojë zhvillimin e procesit të vetting-ut në sistemin e drejtësisë në Shqipëri, një proces tek i cili janë dedikuar kapacitete njerëzore të jashtëzakonshme dhe po ashtu edhe burime të jashtëzakonshme financiare. Për këtë arsye Avokati i Popullit tërheq vëmendjen për një punë më të kujdeseshme të çdokujt në kryerjen e detyrave të tij me përpikmëri dhe jo vetëm kaq: një punë më e mirë është e mundshme nga të gjithë për të përmirësuar frymën e dialogut dhe të mënjanimin të gjuhës e sjelljes konfliktuale si dhe një vëmendje më të madhe ndaj kërkesave jetike të qytetarëve.

Më konkretisht shkelje të lirive dhe të drejtave themelore të individit në

vlerësimin tonë, janë krijuar nga veprimet, apo mosveprimet në vijim:

1. Urdhërat e ndalimit të nxjerrë nga Prokuroria nuk përmbajnë asnjë arsytim në lidhje me shkaqet që kanë çuar Prokurorinë në zbatimin në rastin konkret të një masë sigurie me privim lirie.
2. Nuk janë evidentuar nga ana e Prokurorisë dhe/ose Policisë veprimet konkrete të bëra midis tyre për të dokumentuar orën në të cilën i është kërkuar policisë zbatimi i këtyre urdhrave të ndalimit;
3. Nuk rezulton asnjë dokumentim në lidhje me grupet e ngarkuara nga ana e Policisë për të ekzekutuar urdhrat e ndalimit dhe ose personin përgjegjës (veprimet janë kryer me urdhra verbale);
4. As të ndaluarve dhe as familjareve të tyre nuk u është komunikuar një kopje e urdhërit të ndalimit, në momentin në të cilin u është privuar liria;
5. Oficerët e Policisë Gjyqësore dhe/ose organi i akuzës kanë dështuar të evidentojnë në mënyrë të saktë orën në të cilën personave u është privuar liria;
6. Regjistrat e shoqërimit dhe/ose ndalimit në Komisaritet 1, 2, 3, si dhe në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, janë plotësuar me vonesë dhe jo në mënyrë të saktë, duke u bërë shkak për mostrajtim në kohë e në përputhje me ligjin të të ndaluarve;
7. Procesverbalet e komunikimit të urdhërave të ndalimit, përmbajnë pasaktësi të theksuara në përpilimin e tyre dhe kanë mangësi në lidhje me evidentimin e veprimeve proceduriale, të cilat duheshin kryer në përputhje me Kodin e Procedures Penale; sa më sipër ka çuar në mosgarantimin e të drejtave të ligjore të të ndaluarve;

8. Kërkesa e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Kukës, për vlerësimin dhe caktimin e masave të sigurimit personal ndaj 23 shtetasve të ndaluar është depozituar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Kukës, jashtë afatit ligjor të parashikuar nga neni 258 i Kodit të Procedurës Penale.

Kjo kërkesë është paraqitur në datën 03.04.2018, ora 09:45, ndërkohë që nga pyetja nga ana jonë e personave të ndaluar rezulton se:

- a. ata janë ndaluar në qytetin e Kukësit ndërmjet orëve 02.00 – 05.00 të mëngjesit të datës 01.04.2018.
  - b. nga këqyrja e regjistrave të Komisariateve të Policisë të Tiranës 1,2,3, dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, rezulton se hyrja e tyre në Komisariate/Drejtori është bërë ndërmjet orëve 08.30 – 9:00 të datës 01.04.2018, çka deshmon se ora e privimit të lirisë për çdonjërin prej tyre ka qenë të paktën 2 orë e gjysmë më parë;
9. Gjithashtu Prokuroria ka cenuar të drejtat e të ndaluarve duke llogaritur si kohë ndalimi orën e ekzekutimit të urdhërave të ndalimit datë 01.04.2018, ndërmjet 10.20-12.00, kohë e cila nuk pasqyron realitetin e veprimeve të kryera në këtë rast. Pra për 23 personat e ndaluar, koha (ora) dhe vendi i ekzekutimit të ndalimit të tyre, janë të pasakta dhe nuk janë pasqyruar siç ka ndodhur në të vërtetë.

10. Prokurori i çështjes nuk ka bërë ndjekjen e zbatimit korrekt të dispozitave procedurale nga ana e Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Kukës, ndaj personave të ndaluar, sikurse parashikohet në pikën 1, të nenit 304, të Kodit të Procedurës Penale.

11. Prezenca e madhe e forcave të Policisë së Shtetit gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, megjithëse e justifikuar ligjërisht për shkak të numrit të personave të ndaluar që po gjykohehin, mund të krijojë premisa të intimidimit të trupës gjyqësore për zhvillimin normal të procesit, veçanërisht në rastet kur ka pretendime në lidhje me zbatimin e ligjit nga organet e Policisë. Gjithashtu një prezencë e tillë mund të ketë ndikim në gjendjen e një “presioni të shtuar psikologjik”, tek

personat e tjerë të pranishëm në sallën e gjykimit (personat që gjykohen, apo mbrojtësit e tyre).

12. Duke mos qenë objekt i drejtëpërdrejtë i punës së Avokatit të Popullit dhënia mendim mbi përmbajtjen e vendimit të Gjykatës, në lidhje me formën e tij, jemi të mendimit se një vendim gjykate duhet të jetë i arsyetuar në mënyrë bindëse e shteruese duke marrë në shqyrtim e analizuar të gjitha pretendimet e ngritura gjatë gjykimit, për të përjashtuar kështu efektet negative që mund të krijohen në rastin e kundërt. Vetëm kështu sistemi i drejtësisë do të mund të krijojë besimin e munguar në sytë e publikut.
13. Gjatë zhvillimit të seancës gjyqësore për vlerësimin e masës së sigurisë, janë gjykuar njëherazi 23 persona. Është evidente se ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale në rastin konkret bëhen shkas për mosgarantimin me korrektesë të të gjitha të drejtave që parashikohen në një proces të rregullt gjyqësor për personat e ndaluar, nisur nga numri i madh i tyre. Gjithashtu numri i madh i personave ka kërkuar edhe marrjen e masave jo të zakonshme, për të garantuar ruajtjen e rendit dhe sigurisë në sallë e jashtë saj.
14. Evidentimi më i saktë i vendimeve, komunikimeve dhe zbatimi korrekt i tyre, në lidhje me zhvillimin me dyer të mbyllura apo të hapura të seancës së vlerësimit të masës së sigurimit, do të mënjanonte konfrontime midis familjarëve të personave të ndaluar dhe deputetëve të Kuvendit, me forcat e Policisë së Shtetit, që kishin marrë përsipër të garantonin rregullin dhe sigurinë në sallën e gjyqit. Këto vendime e komunikime duhet të bëhen për raste të tilla në mënyrë publike edhe nga administrata e Gjykatës, për të mënjanuar tensionet në vigjilje të seancës.

Për gjithë sa më sipër Rekomandojmë:

- Marrjen e masave nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për të siguruar interpretim të saktë, e zbatim korrekt të ligjit nr. 8773, datë 23.4.2001 “Për Tubimet;

- Marrjen e masave administrative nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për të garantuar plotësimin në kohë, në mënyrë të saktë, korrekte dhe pa gabime të regjistrave të shoqërimit dhe/ose ndalimit të shtetasve, si dhe aplikimin e procedurave korrekte si nga ana personave shoqërues, edhe atyre pritës, në lidhje me të shoqëruarit apo të ndaluarit;
- Marrjen e masave administrative dhe/ose masave të tjera të parashikuara nga ligji për veprimet e kryera nga prokurorët e çështjes dhe në mënyrë të veçantë në lidhje me mosgarantimin e të drejtave proceduriale për personat e ndaluar. Sa më sipër i njoftohet Prokurorit të Përgjithshëm dhe Prokurores së Rrethit Kukës, për të marrë masat në ushtrim të kompetencave që ata kanë në zbatimin të ligjit, deri fillimin e funksionimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
- Dërgimin e këtij Rekomandimi pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për të vlerësuar për çështje që mund të ndiqen prej tyre, deri në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Tiranë 19 Prill 2018